



Se sa rëndësi kanë dijetarët njeriu kupton vetëm atëherë kur të gjendet në ndonjë udhëkryq dhe nuk di kah t'ia mban, apo kur të bjerë në konfuzion për diç, dhe zgjidhjen, si për të parën po ashtu edhe këtu, e gjen tek sqarimet dhe komentet e dijetarëve. Ky artikull shumë i thjeshtë dhe modest, është një falënderim për Allahun që na ka dhuruar dijetarët, së pari, dhe mirënjohje e respekt për dijetarët, së dyti.

Derisa isha duke hulumtuar për hixhretin e pejgamberëve, alejhimu's selam, më rastisi të gjej një koment të shkëlqyer të Nasiruddin Albanit, hadithologut shqiptar, rreth "Kufomës së Jusufit, alejhi's selam" në librin Kasasu'l kur'an- durusun ve iber të Sa'd Jusuf Ebu Aziz ().

Edhe pse nuk është ndonjë çështje tepër me rëndësi në fe, ngase plotësimi apo mangësimi i besimit nuk lidhen për saj, megjithatë si pyetje shtrohet shpesh nga studentët, dhe atë sa herë që përmendet hadithi përkatës për këtë, i cili siç paragjykohet nga dikush, bie ndesh me hadithin e vërtetë kur potencohet se trupat e pejgamberëve, alejhimu's selam nuk i kalb dheu. Hadithi, përkitazi me kufomën e Jusufit, alejhi's selam, është:

"?? ????? ?? ????? ?? ????? ????? ????????? ?? ??? ??????? ????? ????? ????????? ?? ??? ? ??? :
???? ?? ??????? ?? ????????? : ?? ????? ????? ??????? ?? ????? ??????? ?? ??????? ??????? ??
???? ?? ?? ????? ?? ??? ??? ????? ??????? ????? . ????? ????? : ????? ????? ?? ?? ????? ? ?????
?????? ?? ????????? ?? ????? ?? ????? ????? ????? ?? ????? ????? ????????? ????????? ?????????
: ????? ?? ?? ????? ????? : ?? ??????? ?? ????????? ????? . ????? ?? : ?? ????? ? ????? : ?????
?? ????? ?? ?? ????? . ????? ?? ?? ?? : ????? ?? ????? ??????? ? ????????? ??????? ?????????
?? ?? ??????? ????????? ?? ? ??????? ?? ????????? ?? ??????? . ????? ??????? ????? ?? :
?????? ????????? ??????????? ????? ????? ????? ?? ??????? ?? ??????? ?? ??????? ?? ??????? ???????

...Kur Musai, alejhi's selam deshi te vazhdonte rrugën me izraelitët, ata e humbën rrugën.

Ç'është kjo? – pyeti Musai.

Dijetarët izraelitë thanë: Kur Jusufi, alejhi's selam deshi të vdiste mori besën e Allahut prej nesh që nuk do ta lesojmë Misrin (Egjiptin) pa bartur eshtrat e tij me vete.

E kush e di prej jush se ku është varri i Jusufit, alejhi's selam? –pyeti Musai, alejhi's selam.

Askush, përveç një plake izraelite nuk e di atë- u përgjigjen dijetarët.

Të jem me ty në Xhennet- tha plaka.

dhe Kur'anin e sabahut", ()

...që për qellim është namazi i sabahut por është përdorur vetëm një pjesë e tij edhe pse për qellim është në tërësi namazi. Kështu, falë ndihmës së Allahut, konfuzioni rreth kësaj çështjeje u lagua prej kokës sime dhe shkrova këtë si sqarim"- përfundon hoxha i nderuar, Allahu e mëshiroftë!

Përgatiti: [Sedat G. ISLAMI](#)